




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Në mbështetje të nenit 68 pika 68.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, dhe nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1 pika 1.7 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit, bën:

NJOFTIM

për takim publik

rreth inicimit të procedurave për planifikim, që rrugët "Ibrahim Rugova" dhe "Xhafer Nurkasa" në qytetin e Rahovecit të bëhen njëkahëshe

Takimi publik me qytetarë do të mbahet me **12.04.2022**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit e cila gjendet në objektin e ri të administratës komunale, me fillim në ora **10:00**. Të drejtë pjesëmarrjeje në këtë takim kanë të gjithë qytetarët e interesuar që të jenë pjesë dhe kontribuues në këtë takim.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datën: **08.04.2022**, në ora **16:00**, te zyrtarët: Perparim.Krasniqi@rks-gov.net, Sylejman.Daka@rks-gov.net, Blerta.Gashi@rks-gov.net, dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Detajet lidhur me rrugët e planifikuara që të bëhen njëkahëshe mund t'i gjeni në këto vegëza:

Uebfaqja zyrtare e Komunës: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/takime-publike/njoftime-takimet-publike/>

Platforma e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/meetings.php?InstitutionID=20529&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Facebooku i Komunës: <https://www.facebook.com/rahoveckomuna>

P.S. Duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/66, i datës: 01.03.2022 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, përkatësisht nenit 19 numri i pjesëmarrësve të lejuar në ambiente të mbyllura duhet të jetë deri në 50% të kapacitetit.

Haziz Krasniqi

Zyrtar për Informim

